

**Dritan Mesuli**

*ENGJËLLI IM MBROJTËS*

## *FËMIJËRISË*

Ikëm duke mbetur brenda teje.  
Përplasemi  
nëpër det andej-kendej  
krejt të dhënë fatit  
ndërsa prej kockash zhveshim mëkimet, ninullat.  
Rritemi  
ndërsa stuhi e pjekjes na i rëndoi degët  
si pemët në vrullin e prillit.  
Regëtin trokthshëm gjaku ndër deje  
dhe fëmija burrërohet në fytyrat tona.

Te ndjej brenda meje!  
Shfaqesh muzgjeve  
kur femijët jepen ethshem lojrave në parqe  
dhe gjithçka jotja është krejt e pastër,  
krejt e kapshme  
krejt e mrekullueshme.  
sa,  
kur e breron sërish njomështinë  
jepemi pa kushte  
si lumturisë pa çmim.

\*\*\*

Kur ndjeva herën e parë të çmendem  
isha lakuriq nga tendencat dhe qëllimet  
Dua të mbytem në detin tënd,  
por guximi im  
i ka këmbët më të gjata  
se thellësia jote!

Ti ma ke shkruar emrin në rërë  
dhe unë pres  
dallgën e parë të vdes!  
Fundja  
njohëm nga një fytyrë më shumë!!!

## PËR NËNËN TIME!

Dërgomë një engjëll në mëngjes  
kur kthehem i lodhur nga ëndërrimet!

Kam fituar gjithmonë ikje  
në bixhozët me kurthet.  
Vëre dorën në plagët e mia të merituar,  
engjëll flokargjend.  
Ah, të vdisja  
të mbeteshe përjetë kështu si je,  
mbretëreshë smeraldi,  
Lavdi tokësore mbuluar nga pleqëria.

Eja,  
kur gjumi  
m'i mbulon sytë me kripë ëndrrash të lodhshme,  
Shën Mëri prej balte të ëmbël.  
të mbetesha në prehrin tënd,  
gjiri yt të mi rrihte kockat, gjakun,  
çdo skutë të trupit.  
Ti zgjoja gjithë agimet  
dhe hënat ti bëja fli në lindje pa vdekje!

Nënë  
kurth i jetës-vdekja  
ligj natyre,  
flë e qete tek e nesërmja,  
si ankthi  
dhe ti, e di, do të vdesësh.  
Megjithatë  
le ta mbarështoj lotin e lamtumirës në këso fjalësh  
ku vdekja s'bën vend kurrë!

Ka në jetë ankthe ku ia vlen ti durosh  
ngaqe janë agime të përsququra dashurie!!

\*\*\*

U ktheva edhe një herë nga cak i harrimit!  
Pareshtja,  
rifillim dhe shtysë  
kalëron tik-taket e tërbuara te padurimit.  
Paska herë te fundit!  
Ta quaj rinisje  
Tek e nesërmja gdhitem krejt tjetër.

26 dhjetor 1998

\*\*\*

Oh ç'nuk do të bëja  
të të ktheja aty ku çdo gjë merr trajtën  
dhe ngjyrat e pahumbshme të shkëlqimit.

Kënga e hareshme e diellit,  
zhurma e bollshme e të qenurit  
qumështi jetëdhënës i shpresës,  
rima e hapave dhe dritës,  
kaos i ngazëllimit,  
afsh i dehjes,  
tufat e nuancave që ndjellin pandaljen.  
Oh shpirt sa me ngazëllen!

Pulson brenda meje gjithçkaja,  
tempull i faljes,  
lumë i papërballueshem pareshtjeje  
shikoji gjerat me sy nga vazhdimi

Kitarë shlodhjeje agimi!  
Dëgjoji këngët e mëngjesit!  
S'ka natë për këmbënguljet!  
Kurrë mos hiq dorë nga ajo që ta bekon çastin!

26 dhjetor 1998

\*\*\*

Qirinjtë e fundit  
dua ti fikim  
në shkëlqimin e pastër të së vërtetës.

Kam ikur shumë larg!  
Udhëkryqe të braktisura nga rregulli braktisje!  
S'mund ta quaj frikë dorëheqjen!  
Nganjëherë edhe këmbëngulja është pashije

Heshtja  
tingull i koduar mbetur në cep të syrit.  
Krevati i braktisur i këmbënguljes,  
pentagram i përdredhur në kujën e shtangies  
s'është më idhull i pabesisë.

Mbushu me frymë  
dhe me pathos  
n.q.s do të ma bekosh rrugën.

A s'bie erë mrekullie shpirti!  
E ndjej brerimin e gjakut!

Të pres,  
n,q,s vonohesh  
mbamë mend tek e fundit!!!

26 dhjetor 1998

\*\*\*

Sonte të flas zemërhapur.  
Mendohet engjëlli mes nesh!

Shkëndijë jete  
gota që tokim!  
I dehur,  
rrëkellej gota fjalësh dhe vargjesh që lindin dritën.  
Ne ç'vend të parajsës barazia humb trajtën???  
Asgjékundi!!!  
Pranvera e pambarimit e ka emrin përjetësi.  
Më janë çmendur shpresat dhe dishepujt e paqes  
i kam lëshuar të korrin pabesitë e mëkuara  
në kopshtin e mëkatit.

Ç'zë të ëmbël ka  
bilbili shtatëngjyrësh i paqes,  
dhe i faljes,  
i shtysës dhe pambarimit.

26 dhjetor 1998



\*\*\*

Pritja  
pirg i tulatur yjesh  
në sytë e qiellit të shqyer.

Rropaten brenda meje  
rëniet dhe lartësimet!  
Shpirti, i pa kuptim pa të bardhën,  
rrit pëllumba të verbuar zgjimi!  
Më ka braktisur vetgjykimi!  
Kaq bosh pa fjalën!  
Le të përzihen zhurmat dhe bjerrjet  
sytë dhe lotët.  
Të dua!

Bjermë në rrafsh të ballit më parë se të mi mbyllësh  
paqet në bisht të syrit.

Çapitët ngadalë  
meduza e fatit me sytë e shterrur  
mbyllur në 1001 portash të pagjetshme.

Dua të besoj ty së pari  
më pas ti hap digat e përçafimit të tërbuar  
që rri fshehur në skutat e dyshimit.

26 dhjetor 1998

\*\*\*

Shtroma gjumin e shlodhjes  
në një lumturi të paprovuar.  
Qoftë engjëll mbrojtës qëllimi yt!  
Edhe buzëqeshja!  
Edhe ti!

Jam i lodhur nga ëndërrimi.  
Më mëso të vertetat!  
Më mëso ti këndoj këngët e fitores  
pa mu shqyer flamujt e guximit.

26 dhjetor 1998

\*\*\*

Dua të di  
por psherëtima e kërleshur,  
ironia therëse e heshtjes,  
pjella e pengut,  
kanë çelur shteg për të ftohtin e dhjetorit.

flijim per Krishtin, shpresa!

Heshtja ma ka tërbuar kalin e besimit.  
Jam jetim.  
Gotë pa tokje!  
Mi masturbon nervat pritja.  
Dhe pulsën.  
Shpirtin ma shtyn  
në vetsakrifikim miu të dehur!!!

4 Janar 1999

\*\*\*

Mi ke mbyllur pëllumbat në turitje!  
Mesazhe jetime, vargjet.  
Epruveta të mykura,  
pikëpamje të mpleksura me gjak të kaltër  
aventurierësh bohemë.  
Sa herë u bëmë qindravjeçarë  
në gosti të çuditshme  
në të nesërmen gdhinë  
në këngën e një tjetri gjel.  
Më kujtohen fjalët ogurmira,  
por s'mund ti besoj tani që jemi plakur nga dehja,  
nga çapitjet e vetgënjyera.

E nesërmja,  
në arkivolin e shenjtë të pamëshirës  
i ka shndërruar pëllumbat në larva të mjera.  
E s'na mbetet  
veçse të fiymëmarrim  
mushkëritë tona  
përçudnuar nga karboni steril  
i kancerit idiot të egoizmit.

4 Janar 1999

\*\*\*

Dua ta dëshifroj heshtjen  
E mbytur në molet e braktisura  
të marrosjes së përhumbur.

Fajkua flatërshkulur  
frymëmarrja ka shndërruar  
gjoksin në varrezë dinosaurësh.  
Bie sirena e psherëtimës në guvën e lënë vetëm  
të gëzimit  
dhe sytë e lidhur të çastit  
rendin kokëprerë  
si Shën Pjetër  
mjekër rruar.  
Dhe s'ia kuptoj kujën bilbilit.  
Kod i valëve e humb fladin e thellë të oqeanit  
dhe pulëbardha mi ndjell vargjet  
në kopështin e çartur të keqardhjes.

Dua t'ia lidh këmbët trishtimit  
Që ti prish sytë  
dhe pentagramit të fytyrës i jep  
kafkën e ngrënë të fantazmes.

Nëse do ta dëshifroja ofshamën e këngës sime,  
dielli dhe kripa e gjelbët e dallgës së fjalës  
do ta ndërtonte fluturimin  
në vela dhe qiej  
fshehur nën petkun e padëshifrueshëm të muzgut  
që tani,  
këtë çast,  
kur kënga ime,  
vargu im,  
çapitet në harrim krejt të paemër,  
më përplas në hone të egra fjalësh dhe terresh!

\*\*\*

Jeta  
përrallë më e vjetër se koha!  
Çapitet drita  
në trokun e shekujve të patjerrshëm,  
dhe bregu i lindjes i kthen valët  
në agime të kaltra fluturimesh dhe zogjsh.

Kur njësohen perëndimet  
dhe yjet e këputura që kërkojnë pamb  
ritmi i rrjedhës  
i ngren këmbanat e jhonave  
në humusin e nesërm të diellit.

5 Janar 1999

\*\*\*

Të jesh i lumtur!  
Aty fillojnë të gjitha mrekullitë!

Shpirti  
çelet  
si një agim i qashtë  
në fytyrën e një rilindjeje të praruar.

Gufoji kuajt e guximit  
dhe jepu krah nga ëndrra që të rrit!  
Krimbi i frikës  
është i dobët karshi dritës.

Ta dish  
do vijë një ditë  
dhe do kuptosh  
idhujt janë të pakuptim  
ashtu të padukshëm!

1 Mars 1999

\*\*\*

Dallgë e pamposhtur,  
kalë fluturak,  
vëlla i qëllimit  
bekoje dhe uroji fat,  
detarit endacak që ka fytyrën tënde!

4 Mars 1999



MUZG

Kaq të thjeshta gjërat!  
Si këto fjalë  
këtë çast  
ndërsa jashtë bie nata!

21 Mars 199!

\*\*\*

Sikur ti numëronim të vdekurit  
dhe barqet ndjellakeqe të Trojave,  
sikur traktatet kobëzeza,  
ti shartonim me heshtjen e një varri kolektiv  
dhe mushkat e ngarkuara të shesheve dhe kthesave,  
gjirizeve, skutave,  
të djeshmes, të pardjeshmes,  
ti ndriçonim, fundja, edhe me një qiri,  
s'do të besonim  
se e nesërmja  
qenkesh si fati,  
i shkruar në rërë.

23 Mars 1999

\*\*\*

Ku kanë mërguar çastet  
kur mëkuam në gjoks të njëri-tjetrit  
ndershmërinë???  
Falmë njeri...  
një shtysë...  
...fundja edhe të vdes!  
Ah, ofshamë e çnjerëzuar  
ta shohësh të birret Omonia  
dhe Athina të flerë mbi  
fetuse dallgësh të vdekura në shkëmbenjtë e nëmur të  
Egjeut.

Mëshirë për Odisenë  
shitet në hyrje te Akropolit.  
Falmë njeri  
nje shtysë  
...fundja edhe të të lyp!

Ah, Greqi  
tokë e lënë djerrë, buzëqeshje e restauruar,  
çapitesh sakate  
buzë Egjeut të plakur  
nga kufomat e grekëve - ikanakë apokalipsesh.  
Në të pastë mbetur edhe pakëz nder dhe lavdi  
arnoje flamurin tënd që jep shpirt  
si nje armë që se pa kurrë sheshin e luftës.

Falmë  
Athinë  
një shtysë...  
...se paku të psherëtij.

23 Mars 1999

\*\*\*

Na ka braktisur shpirti!  
Kanë perënduar ditët  
kur nga frymëmarrja çelnim trëndafilë.  
Të largët muzgjet  
kur mblidhnim dallgët  
dhe endnim udhëtime për në toka të reja fitoresh.  
Thonjërritur,  
Të kërleshur,  
si një rrugë në stuhi  
mbuluar me gjethe dhe degë të thyera,  
rënkojmë me jehonën e një këmbane të shurdhuar.

Oh sikur ti kujtoja fjalët,  
vetëm fjalët!

Provo ti vesh metrikë kapitenit,  
mbyllja krahët engjëllit  
dhe PITER PANIN  
urdhëroje të rritet!

Edhe sot jemi gjakqelbur!  
Po nesër???

Kujtimi i muzgjeve  
kur mblidhnim dallgët  
na mjekon guximin!

Ah s'na ka mbetur veçse të guxojmë!  
mjerë ne njerëz,  
mjerë ne!

E besoni,  
nuk qemë kurrë fatkeqë!!!

23 Mars 1999

\*\*\*

Mos më pyet  
ku mërgoi Sokrati!  
Mos më pyet në ka mbetur gjësend brenda nesh  
nga Krishti!

Flas!  
Thur vargje!  
Plugoj muzën time  
të mbjell parajsat!  
Mbarështoj poezi, njerëz,  
dhe jo armë.  
Lind qellime  
dhe jo varre.  
Këndoj këngë  
dhe jo kuja!

S'ka kush ti largojë lumenjtë e shurrës shumëkombshme  
në traktatet e paqeve!

20 Prill 1999

\*\*\*

Loz era në degët e ullinjve  
ndërsa vargjet ngjyhen me rreze të praruara dielli.  
Ah' ç'kuptim ka jeta teksa zogjtë cicërojnë  
dhe këmbanat lajmërojnë oren 7.  
Buzëbrëmje!  
Është lëshuar hareja rrugëve  
dhe mbledh portokalle të egra.  
Nata shpërthen vrullshëm  
si turr fëmijësh në lojra të pafajshme.  
Do të doja të zgjaste kjo hare  
një jetë,  
sa pavdeksia.  
Sikur të mi gufonte krahët flladi pranveror,  
të mi vishte kërcenjtë Egjeu.  
Të shtrihej në shtatin tim Akropoli!  
Madhështia e Olimpfit të më mbushte dejet,  
gjurmët e Sokratit,  
filozofia - streha e shpirtit  
të dehte endacakun e lodhur të fjalës

Muzg i vonë!

Vlon kaosi i gjasave, zgjimeve,  
I vdekjes, vazhdimit.  
Ndez cigare në rrugën "Skurtanjoti"  
i bindur se jetoj kësisoj!

Jetoj!!!

20 Prill 1999

\*\*\*

Më vlon gjaku ndër deje, sot!  
Më rrahin pulset, sot.  
Ia kam lënë të djeshmes pengjet.  
Fllad i shpirtit më rigon gjakun.  
Kalin e shtysës, vullnetit,  
e kam mbathur me flatra engjëjsh!

E djeshmja,  
rreze e mbetur në copa xhamash!

Kurrë më shumë se sot se desha jeten!  
Kurrë më shumë se sot  
nuk ia kam hapur porta shpirtit  
ti jepet lirisë!

20 Prill 1999

\*\*\*

Po ti them gjërat shkoqur, mik!  
Sa duhet të bëj sonete,  
sa duhet të braktis  
të arrij të tjera.

E kapshme lumturia!  
Tek fjalët,  
tek e thjeshta,  
tek mbrëmja.

Mos më braktis qetësi!

Frymëmarrja e yjeve,  
turravrapi i reve,  
kukafshehti i hënës,  
tingujt dhe zhurmat.  
Të lehurat e qenve dhe golgota e mbrëmjes  
në rrugët e tejngarkuara nga ikja pambarim.

Kotet limani i Piresë  
Mbretëron majë Athinës akropoli  
dhe nata mbarështon muzën time  
në kaosin e thjeshtësisë.

Mos më braktis art i fjalës,  
rreze drite,  
shtysë dhe engjëll  
për detarin endacak të fjalës.

E ndjej pulsën e egër të ëndrrave

Gjasa dhe kushti  
vëllezër qëllimi  
rinë këmbëkryq në tryezën time.

Qetësi,  
horizont i të qenurit!!!

Oh, engjëlli im endet në pakufijtë e mrekullisë.

Të përshëndes, mik  
i dehur prej pandaljes,  
i dehur prej vrullit,  
i dehur prej qëllimit të mirë!!!

27 Prill 1999



\*\*\*

Ha bukën tënde  
të mbetemi miq!  
Linde buzëqeshjen të të kuptqj armiku im.

Këtë natë çirren yjet e largët:  
unë betohem në emrin tënd!  
Bekuar qofshin bijtë e tu.  
Shtrati i tyre  
vloftë nga ëndrrat  
dhe rruga u mbaroftë tek pambarimi.

Armiku im,  
ha bukën tënde  
sonte  
gatuar në galaktika fjalësh dhe yjesh  
që çirren.

28 Prill 1999.

\*\*\*

Bjermë në rrafsh të ballit!

I mbyllur maje Akropolit  
rrjedh përgjatë Misisipit  
për tu bërë liman paqeje në Bermude.  
Kaloj Skandinavet dhe Apeninet  
të arrij Tibeitin e largët  
në Pashkën e vitit 2000.

Mi lidh duar e këmbë!

Në zemër të Afrikës  
martohem me orakullin kinez  
dhe nxjerr jashtë ligjit  
të drejtën për të qenë femijë në Honkong  
Më është mbytur Parisi.  
Më dhëmb Hiroshima e karbonizuar  
dhe Okinawa bën banjë dielli në Izrael  
Wonderland-i përpëlitet  
dhe koncerti festiv i apokalipsit  
ka kohë që lajmërohet me 25 Dhjetor-in e fundit,  
ditë kur La Mansh-i do bashkojë qiell dhe tokë.

Pritma gjuhën!

Shumohet ne miliona fjala ime!  
22 vjeçare shpresa  
kalëron dinosaurin e 23 që e tërheq për hunde.

Truni, spermë e dalë boje!

Kaosi dhe Koloseu  
fytyra e Romës.  
Ciceroni bëhet vëlla me Hitlerin,  
Në djep përkundet Milosheviçi  
që sheh në ëndërr Monikën të luajë bixhoz me Kosovën.

Në Bon mbarështohet mëshirë.  
Në Rusi ngrohen me kufomën e Leninit.  
Në Tiranë njerëzit, bulevardëve dhe rrugicave,  
duartrokasin idhuj të vetvlarë.

Nuk ka cep rruge të mos thërrasë shurrë.  
Nuk ka themel pallati të mos thërrasë: urinë.  
Dhe njeriu  
si një qen endacak krenar  
mohon shenjtin e vet.

Trilionë Golgotat e Krishtit  
kushedi sa mohime Shën Pjetri.  
Kulla Eifel,  
lapidar për Judë tradhtarin.  
Fjala,  
arma primitive bën dietë dobësimi  
në cica macesh të lemerisura në Turqi,  
Qipro, Kretë, Athinë!

Çmënduria, shpëtim i pasosur  
mbledh rreth saj vetvrasës të penduar  
që gatuajnë testikuj të shterrur,  
në kafkën aksidentale të Kamysë.

Bjermë,  
sa te bjerë këmbana e parë e së dielës së Pashkës.  
Balli im fushëbetejë nocionesh  
qoftë fundi i çfarëdolloj golgote,  
i çfarëdolloj lufte,  
për hir të asaj të vërtete  
që e mërguam me dëshirë!

29 Prill 1999

\*\*\*

Dyshimi  
stuhi e nëndheshme  
ka molisur vargun.

Kthema kufomën e mbetur përmbys!  
Syri gjysëm i hapur  
projektligj pro paqes!  
Mos të më merret haku.  
Janë shterpë fjalët e mia!

Buzë rrugës le të mbetem  
Si një mbeturinë e patretshme.

Qelbet, e di, poezia e mesnatës,  
ndërsa plane dhe vorbulla ziejnë ngado  
Përgjatë zvarrjes,  
ofshama lëshohet e tëra  
në zgrip të dhimbjes.  
Dhe vdes engjëlli mendueshem në shtrat të budallëkut  
me serum të murtajës në testikulin e çmendjes.

Kthema kufomën e mbetur përmbys  
në cak të mëdyshjes!  
Ik më pas, pa kthyer kokën.  
Uroj që tek kthesa tjetër  
krimi të ketë dalë jashtë mode!

29 Prill 1999

\*\*\*

Zogj të tulatur qytetesh zhurmëmedha  
vargjet e braktisura në kolona pallatesh!  
Qofsh shëndosh e mirë kudo qofsh, copë jete e braktisur.

Të pres,  
ani se shumë po vonon  
Jam limani yt krahëhapur që s'jepem.  
I rrahur prej dallgësh  
dhe i kërleshur prej sa e sa sprapsjesh,  
qëndroj.  
Në buzët e mia  
pika e fundit e gjirit të nënës  
është bërë burim jete.  
Di vetëm të përshëndes tani!  
Mëkatar dyshimi,  
e megjithatë shpejto.  
1001 netve të ardhjes le tu shtohet edhe një  
mjaft të ma njomesh filizin e ronitur të shpirtit.

Rend!  
Të pres krahëhapur ditë-natë  
në breg të pritjes,  
tejet i mrekulluar nga aroma jote e largët  
që është imja,  
imja,  
imja!

29 Prill 1999

\*\*\*

Fle Athina  
në gugatjen e kulumrive.  
Frynflad!  
Ah, të mbetej vazhdimësia këtë çast  
dhe tik-taku i mëpasëm  
ta zgjonte botën në lëndinë të paqes!

29 Prill 1999

\*\*\*

S'të mësoj të vërtetat!

Ani,

në e tredha kapitenin

dhe e flaka në hon të çmendjes poetin.

Ani,

në përpëlitet brenda meje shpirti në rënie.

Ka dështuar pakti për përsosje në çdo ind

dhe ameba e çdo shprese

shturet pa e parë molin e lulzimit

në agimin e paqes.

I mësuar me terrin,

dishepull i cepeve dhe i lypjes

qelbera si e zakonshmja.

S' shtyhem të jetoj

edhe pse s'dua të vdes.

Kërkoj kult.

I rrëzova kultet,

krejt i çakorduar

ndjehem edhe njëherë i aftë të kuptoj shtysat!

Maj 1999

\*\*\*

Det tetori, muza ime buron ujë të freskët shprese!  
Oh sa i dridhshëm  
Tingulli i mëngjesit  
Jam fëmijë i të gjitha kohërave  
gjithë shteteve,  
dhe gjaku im breron cep më cep.  
Jam i egër  
dhe psherëtima akordohet  
si një tingull pranvere  
në honet e guximshme të lirisë.  
Troku,  
turravrapi prej femije,  
poezia,  
oh të gjitha gjërat kuptimplota  
që më mbushin trupin  
ma egrojnë fjalën  
dhe rrugët e pambarimit,  
diejt e së nesërme mi mbarështojnë rrahjet,  
dua të ti jap sot  
22 vjeçar siç jam,  
më shumë se kurrë i pamposhtur  
si guximi!

Sikur të ti mësoja shtigjet e fluturimit,  
të të merrja për një botë pa kushte  
unë- pjellë e së thjeshtës  
bir i natyrës,  
idhull i paganes,  
dishepull i përparimit

Ti zhdukja kufmjtë  
dhe të këndoja tingullin e egër të detit,  
trokun e çakorduar të Veriut,  
vrugullimin e brishtë të limfës në pranverë,  
pamposhtjen e pemës nën fuqinë  
e lulëzimit të vrullshëm.

Më ka lindur natyra

3 Maj 1999



Marjetës

Të lëngshme buzët e tua!  
Ma rrethon trupin me vragujt të trupit tënd  
Që janë si gjuhët e bjeshkëta të lumenjve.  
Të marr erë,  
nokturn i stinëve  
përsosje balte që më ngazëllen  
dhe më çart ndjesitë prej burri!

Ah, forma jote!  
Mas lartësitë  
me athshmërinë e parajsave të tua që lëshohen  
si zogj krenarë.  
Më rreh aroma jote  
edhe kur unë nuk ia njoh vetes  
instiktin e asaj që më ngazëllen  
dhe ti lëshohesh bri meje me krejt çke,  
ti di të më kthesh nga arratisjet e panjohura.  
Dashuri,  
ujëvarë e pandalshme me emrin femër!!!

4 Maj 1999

## PËRSHTYPJE

Unë  
kufomë e pakallur  
buzë rrugës  
me vdekjen në cep të buzës,  
krejt injorant  
dhe i lumtur.

Si një akrep i çarmatosur!!!

12 Maj 1999

\*\*\*

Fëminore  
si pafajsia,  
nata më kthen tek botët  
ku gjërat kanë fytyrën e shpirtit!  
Si vlojnë pulset!  
Frymëmerr ballkonëve vera.  
Larg, deti artikulon serenata dashurie  
për largësinë e pamposhtur me tokën.  
Avullon natyra ligje erëmira  
dhe ninulla të pavdekshme.  
Kodi i së nesërme: dielli  
Hëna lozonjare fle diku,  
përtej taracave që i jepen natës.  
Pezull mbi Athinë  
darka e perëndive-smog mrekullie.  
Tolerancë  
perëndimi i diellit.

Mi mëkon kthimet  
Si plagë shekujsh  
poezia,  
netëve.

I molisur nga vargu ndihem!

Qershor 1999

\*\*\*

Çapitem në rrugë me emra engjëjsh.  
I kam mbushur pasionet  
me lojra fëmijërie.  
Shikoj larg.  
I lodhshëm durimi,  
Fitorja më josh!  
Flamujt e paqes  
dhe fjalën  
ua kam gdhendur vrullet  
me frymë shenjtërisht!  
Barazuar janë tashmë raportet  
dhe mëngjeset  
gdhijnë në dete të kaltra ringjalljesh!

Çapitem në rrugë me emra engjëjsh!  
Flas gjuhën e engjëjve.  
S'më duket shtirje  
të më mësosh ç'është virtyti.  
Dhe nëse patetika ime të duket e lodhshme  
të më besosh!  
Jam detar i lodhur  
nacionesh dhe ëndrrash.  
megjithatë  
një ditë prej ditësh  
fjala ime do të jetë mol mikpritës  
për rrugëhumbur të tjerë.

16 Qershor 1999

\*\*\*

Më pret i lodhur, i plakur tek porta  
Argosi i jargavitur i fundit tim.  
Mësova të tradhtoj  
ndërsa flirtova me qindra Ofeli.  
22 vitet e ëndjes  
masë pa peshë dhe këmbë.  
Ënderroj Penelopën  
të mos mbarojë sixhaden e premtuar për vlesën e re.  
Më dhëmbin brazdat e hapura në trup.  
Rroj me virtyte shterpë  
të mbaj gjallë fëmijët e veshun me prezervativ.

Gjaqet e pa marra  
i kanë kthyer vëllezërit në hiena!

Lypsar,  
ndërsej Argos-in të kapë bombën pa shpërthyer.  
Më kot gërryey plagën në këmbë të majtë!

Mirëpres vdekjen,  
Ndërsa numëroj kështjellat e rëna të shpresës.  
Shiu i vonuar  
ma nduk gjuhën  
dhe testikuajt e plasur të gjenezave  
shkërdhehen në moçal burrërie  
ne mes të Grinuiçit.  
Në një jetë qeni  
qeni është miku më i mirë!!!

16 Qershor 1999

\*\*\*

E kam të lodhur trurin nga nocionet!  
S'bëj më shkencë.  
Dietë dobësimi  
udhëkryqet ku shes letër higjenike.  
këtë fundshekull  
s'ndihem njeri.  
Ekzaltime të eksituara tejmase  
si ndjesi të masturbuara pa karar në 7 ditët e javës,  
protesta për një virtyt më shumë  
më shtyn në mëkat.  
Engjëjt janë ndalur tek dritat e kuqe.  
Të çmendur semaforët s'tregojnë drejtim.  
Kam nevojë të kthehem mbrapa.  
Të jem kafsha kurioze  
që zbuloi zjarrin,  
që besoi tek barazia ndërsa zgjedha e skllavit  
ia shpinte lugën deri tek goja  
dhe e shqelmonte si një uri e pangopshme.

Barazia,  
seks në pjatë.  
Kod homoseksualësh  
mospajtimi ndjell luftë.  
Paqja,  
bukuri që vret.  
Mikpritja  
virtyt për urrejtje.

Jam i lodhur së ulërituri,  
raskapitur së renduri  
dekadë pas dekade për hiç të fundëm,  
Sizif në fat,  
Don Kishot në të vërtetë,  
më gjymtyrë të mbushura deng  
nga çibanet e injorancës!

16 Qershor 1999

\*\*\*

Tendencat  
vargje të mërzitshme!

Revolta e mbledhur në fyt  
ulërimë e pa guvë.  
Beso,  
edhe pse je më lart se kulti.  
Ndërtoja fole në shpirtit me virtyte.  
Është bixhoz guximi.  
E lodhshme humbja,  
më e madhërishme fitorja.  
Port ancorimi për endacakun  
pambarimi.  
Dhe mos harro  
guxo më parë,  
me pas gjyko!

18 Qershor 1999

## PA RRUGËDALJE

Kaq vetëm  
i shoh gjërat përgjysëm.  
42 gradët e mbijetesës  
përçapje të kota!!!

A s'më thua  
Ç'kuptim kanë gjërat në terr!??  
Dhe pabesia.  
Dhe dorëlëshimi.  
Dhe vetbrejtja!!!

Sa keq kur të lidh gjaku  
me gjaksorin.

18 Qershor 1999



\*\*\*

Kok a pil në rënie  
kthesa!

Shumë të kërkova  
kur të gjeta  
s'munda të të besoj.

Ishe më poshtë se unë!!!

18 Qershor 1999

\*\*\*

Në patituj  
poezia kalëron shpirtin për në Nirvana!

Nuhati shtysat  
dhe gjasat!

E kam shpirtin të mbushur me fllad!

18 Qershor 1999

\*\*\*

3 idhuj në darkën time.  
I pari jam unë!  
I dyti jam unë!  
I treti jam unë!

3 botë të pakoha!!!

18 Qershor 1999

\*\*\*

Dostojevsk në breg të detit  
mbledh rrathët dhe flakët e mërgimeve të mia.  
Në më duhet të të gënjej  
bësomë deri ku të shpie drita ime.  
Mbledh psherëtimat e mia të tymosura,  
shpirtra në sorollatje,  
në shishe djallëzish dhe kurthesh,  
Nxirrmë nga e djeshmja pa u tutur.  
Më ka mbetur në flokë një ëndërr e fundit.  
Ti mbush hundët me opium!  
Luftëtar krahthyer  
me penën ndezur flakë nga ironia  
të ftoj në duel.  
Eja ta ndezim një cigare  
dhe ti zgjidhim udhëkryqet.  
Kaq shumë gjëra për dorëheqje.  
dhe shpresë çdo ditë e më pak.

Vullnetpak engjëlli im mbrojtës, më lë vetëm  
dhe kurvëron andej këndeje  
ndërsa unë humb në gryka revolverësh.

Ta ndjej mungesën shpirt,  
kudoqofsh!

18 Qershor 1999

\*\*\*

Zot e Krisht  
zar në ruletë!

Djall e ferr  
zanoret e vetvrasjes!

Jepma dorën,  
së paku shtymë!

Kaq pezull sa ndihem  
më duket e mërzitshme përsëritja!  
Në mos si borxh  
nga mëshira ta kërkoj!!!

18 Qershor 1999

\*\*\*

Engjëlli im mbrojtës  
gozhduar në cica të rëna,  
ti kam mbledhur currilat e gjakut.  
në orgazma dhe orgji shumëkombshme.  
Me dhëmbin kyçet e tua.  
Fundjavat që na bashkojnë  
dhe meshat me gjak Krishti,  
Apokalipset e parashikuara  
dhe shpëtimi i pashmangshëm si mëkati,  
lutjet dhe përshpirtjet e pashpresa  
si vëllezër të abortuar,  
pemë trashigimie të kalbëzuara që në bërthamë,  
dhe idhujt në 3 kohët e pakoha  
që tne akordojnë vetvrasjet dhe kurorëzimet.  
Lavdia dhe paraja,  
mbarëvajtja dhe urrejtja,  
fjalët, shtysat, të nesërmet, kujtimet,  
reliket e kohëve të shkuara,  
statujat dhe buzëqeshjet e restauruara,  
oroskopët dhe letrat e mbetura në thonjtë e paprerë,  
janë buka dhe kripa jonë!

Diku mbi kokën time  
qëndron në shënjtërim të verbuar.

Dua të të thith plagët!

Engjëlli im mbrojtës,  
Në çdo Shën Pjetër,  
në çdo Shën Gjergj,  
dhe sa herë zhvesh. prej vetes një lëkurë,  
thur kurorë ofshamat e tua të përzishme.  
Më janë ndrydhur fëmijët  
dhe shojet e ngrëna të këpucëve  
lëshojnë lot të kalbur sysh dhe damarësh.

Dua ta bëj timen  
dhimbjen tënde,  
të shënjtërohem!

9 katet e shpirtit  
mbushur me putana të dala në pension.  
Profilaktikë të skaduar  
harxhet që paguajnë pasardhësit

dhe gojëdhënat kanë humbur kuptimin  
për fushata elektorale.

Engjëlli im mbrojtës,  
krijesa pa fytyrë e mëngjesit dhe dritës,  
naivitet lakuriq dhe ndëshkim i mjerë,  
nuk di si të të mëkoj  
dhe të injektoj brenda vetes bacilin tënd të molitur,  
ronitjen tënde të zvargur,  
gjysmën e këmbës në varr të pabesisë.  
Psherëtimi dhe mëshira  
S'më shpien më larg se bjerrja.  
S'mund ti bëj vend brenda vetes, çmendjes  
dhe miqtë e rralluar,  
gishtërinjtë e prerë,  
kafazet e boshatisura të gjokseve  
me çfarë ti rilind  
kur edhe ti,  
rezja e vetme  
rri velur majë cicash dhe klitoresh të çmeritur.

Linde tingullin e shumëpritur të akordojmë kitarat e lartësive!

Ti dhe unë  
pasqyra të njëri-tjetrit  
mbetur ne errësirën e dy botëve  
pa urëlidhëse në mes!

19 Qershor 1999

\*\*\*

Bares rrugëve  
me një ndjenjë patriotizmi të përdhunuar!

Megjithatë  
jam krenar  
pse jam shqiptar!!!

19 Qershor 1999



\*\*\*

Parandjenja, valëz frike  
lag molet e brejtura të besimit!  
Pijanecë pa fantazi,  
boshatisur nga shija  
rrëkëllejmë një të sotme  
të bollshme.  
Vajtje-ardhja  
nëpër vitrina pozon paqëllimin besnik.  
E heshtur rruga,  
e braktisur edhe nga gjethet.  
S'ta njoh fytyrën.  
Zanoret e fikura të nderit  
janë drita të thyera,  
S'më përket, ta dish.  
Besoj tek vdekja si tek çdo gjë tokësore!

Të kam ftuar në sofrën time  
qëkur mësova ta udhëheq fjalën cep me cep.  
N.q.s ëndërron  
që ylli të bjerë në xhepin tënd  
je miku im!  
Falmë,  
s'dua ta prish ëndrrën tënde  
mbuluar nga vorbull drite  
në kaos të çmëndjes.  
Të shumta përçapjet  
e dritë pak për bodrumet e dijes.  
Nuk jam vetëm  
në përshpirtjet e mbasditeve.

Të adhuroj  
pse më mëson ikjen  
dhe kjo me mjafton  
të fle në shtrat me frikën  
se nesër apo pasnesër  
edhe parandjenja do më braktisë!

\*\*\*

Vorbulla  
fundjavat mbytur në kënde të shtrembëra kolonash.  
Tërmetet mi kanë kthyer llavat në litar mbyjtësh.  
Jam nisur tek ti  
të takoj dikë tjetër.  
I ndyrë pakti që bëmë.  
Uromë rrugë të mbarë  
dhe time më flake në hon të plakjes së ngadaltë.  
Bekuar qofsh, nënë, ani pse mbasditet e largëta  
ç'ngjyrosin argjendin e ujëvarave të tua.  
Në rrugën Skurtanioti  
im atë thërret ithtarë të pijes  
të dehën në tatëpjetën e pafund të Sizifit.  
Të çmënd pritja!  
Vorbull nikotine  
kullat dhe faret që ndërtojmë çdo ditë.  
Do të doja të ti nxirtja sytë  
dhe të përshëndesje në gjuhën time.  
Do të doja te iknim deri tek rreziku  
duke guxuar si kurrë më  
e të ktheheshim më pas të burrëzuar tek fjala "paqe"

Po humb fjala ime pak nga pak  
si fjolla e fundit blu e cigares së fikur.  
Të mbetësha fëmijë.  
Oh, në dasma me luledele në lindnim fëmijët tanë.  
dhe tregonim bëma për gjyshërit e panjohur.  
Të shqyer i ndernim flamujt  
gjithësesi mëngjesi që yni.  
Më dhëmbët e Bakut në gjymtyrë të qëndresës  
mbillnim dëshirat dhe krasitnim cepet e syve  
të infektuar nga djallëzia.

Tregoja rrugën tjetërkujt.  
S'të njoha  
megjithatë të tjerë më vinë pas!  
Bëmë strehë sonte,  
le të jenë reflektime epshndjellëse të shtunat e bordellove,  
ogurmire përpyekja.

Flenë në fund të detit kujtimet.  
Të thashë dua të mbetem fëmijë,  
si hareja,  
si pafajsia,  
si padjallëzia.  
Më kanë mbuluar ethet e ngarendjes

e ndihem krejt pa fytyrë  
mbuluar me kaosin e mjegullt të vetmisë.  
E kupton vetimponimin???  
E mjerë hipoteza  
dhe s'këmbëngul të bëj pjesë në darkën tënde pa me ftuar.  
Ligj natyre vazhdimësia  
dhe në shalët e mia engjëjt endërrojnë  
një parajsë më shumë.  
Kurrë më shumë s'iu tremba vdekjes se sa dje  
dhe kurrë më shumë se sa sot s'ia ndjeva brenda vetes  
vrullin jetës.  
Mos i rregullo shtresat,  
i kujtoj të gjitha ëndrrat  
edhe pse ti mi mbush me tym të hidhur utopie.  
Këmbanat në festa shenjtorësh  
dhe buka e bekuar e Pashkës  
si vëth snobisti  
mbjellin fidane parajsash në mushkëritë e mia.

Rruga e humbur fle diku brenda nesh  
vetem se ne nuk e ndejme  
tingëllimen e mrekullueshme të ujit  
në rënien e rreshkur të gjykimit.

Kërkoj ti ndjesh fjalët e mia!  
Kaq të ndryshëm,  
kordinata të pagjetshme botësh  
qëllimi i mirë  
na bën një.  
Jeto!  
Gjithmonë do të kërkoj,  
në më gjetsht  
fundja edhe kafkën të brejtur,  
cepi i buzëve dhe shpirti,  
do të ndezin dritën e shpëtimit.  
Më kujtohet  
s'kam dashur të rritem!  
Tani ndihem i plakur  
në zverg të fjalës sorollatje.

Oh, shpirt i panjësuar,  
rob i territ,  
mos kërko të më njohësh.  
Psherëtima është fytyra ime  
dhe gjoksi yt i njomë  
s'do ti bëhej fole shqiponjës mësuar me hapësirat.  
Jetoj çdo ditë me Sokratë pa arsye  
Shtrydh seksin çdo ditë në trupin e Helenës  
dhe fetuset e Akropolit, Spartës, Salaminës,

Artemidës, Athinasë, Afërditës,  
i gatuj në darkën e moskokçarjes.

S'them të jenë të mërzitshme  
lëkundjet dhe tendencat vetvrasëse të dallgëve.  
Vdes nga dëshira të të njoh  
dhe të të mësoj çdo të thotë të dalësh prej shpelle.

Dua të flas për time më,  
vëllanë e mbytur në verbërinë Kainiane  
që përnatë më mëson ikjen.  
Dua të të flas për vendin e shqiponjave  
andej nga kam gjakun!!!

I kemi hapur letrat  
dhe përmasat e respektit kanë kufi orën 14-20.  
S'kanë vdekur të parët,  
S'do jem i fundit që të kërkoj.  
Zjarrit të shpirtit hidhi limfë dashurie  
dhe te nesermet e fëmijëve mbarështroji  
jo më në bodrume të ndyra pallatesh.  
Koha të ngre pengesa.  
Ta bësh aleat tëndin të nesërmen  
dhe rrugës nga ec mësoja tingullin  
të mos ndihesh vetëm.  
Lërja të djeshmes pengjet.  
Linde diellin e mirëkuptimit  
dhe mos kërko t'më gjesh!

Gjithmonë jam krah teje  
duke të mësuar fjalën "PAQE"  
në gjuhën time!!!

26 Qershor 1999

\*\*\*

Këtu të pres  
me erën e ndrydhur  
në duart që kanë kapur qiellin.

Gjoksi im  
bregpritës dallgësh,  
rrit shkëndia të pavdekshme dashurie  
ndërsa  
ti rend  
me trok-un e së nesërme  
të mi kthesh psherëtimat  
në parajsë të harlisura puthjesh!!!

26 Qershor 1999

\* \* \*

Me putana  
gdhijnë mëngjeset pegrine!  
Ngarend gjithandej.  
Bekoj me romantikë të thjeshtë  
udhëkryqet ku mendohem për rrugën time.  
U jap krah epsheve të mia të çiftuar me horizontet  
dhe kurbat e lumturive tokësore i blatoj me balsam yjesh.  
Uromë jetëgjatësi sa herë!  
Me semaforë dhe psalme endacake  
këndoj oktava nate që mbërrijnë parajsa  
dhe lindin engjëj!  
I pavdekshëm është fluturimi  
edhe kur shuhet shpresat e shiut.  
Jetoj në kaosin e ëndrrave të mbetem femijë  
dhe të endem përrallave si një utopi.  
Nata, deti, frymëmarrja e trotuareve,  
pentagramet e ëndjes!

Të dua jetë!!!

28 Qershor 1999

\*\*\*

Vrapojnë yjet  
si të lehura qensh në alcosin e pushtuar të Athinës.  
Shtrihet rrugëve një rregullsi gjumi  
dhe ëndrrat turiten nga prekja.  
Heshtin udhëkryqet  
dhe amvisat servirin gjysëm hëna dhe kryqe të kuq  
gatuar me thithka të virgjëra cicash!  
Jodi i Egjeut gërryen brigjet  
dhe mbledh copat e flakura te Poseidonit.

Copa jete!  
Mbushet kisha e pagjumësisë sime  
me dishepuj te thjeshtë, endacakë, që besojnë në aventura.  
Përplasen gjithandej fragmente të lodhura vere  
në dhomën time të mbytur në moçal birrash të shterrura.  
Idhujt e mi kokëposhtë  
të bërë gati për vetvrasje  
rrinë këmbëkryq dhe presin  
shenjën time për një fund gremisë,  
dhe fqinja gatuan sytë e saj për fjalën time të uritur.  
Skurtanjoti, Saranti dhe copa qiejsh  
dhe muzikantë endacakë me tinguj të mekur memecë  
janë bërë ndjekës gjurmësh.

Rrallë bien yje në tokën e 1001 dëshirave por  
pa asnjë shpresë!  
Shesheve shetit nata shtatzanë!

Simfonia e rrugëve  
ma verbon Bethovenin  
dhe çelësi i solit është një grua plakë  
që më prish sorollatjeve  
në sheshet dhe rrugët ku s'bie asnjë yll.

Pushuan të lehurat.  
Dallgët e yjeve i frynë velat për në padashje  
dhe armiqësia tregon përrallë  
për heronj të tredhur  
në Qipro, Omonia,  
dhe në fund të detit  
ku fle shpirti grek i përzënë nga parajsa.

Rreth e rrotull Akropolit  
në kurorat e ullinjve  
pëllubat çiftohen me larvat  
dhe vejushat zhyten në kollona të mbetura bosh divorcesh.  
Është jetë e paqtë që i mungon paqja,  
kjo mace e shqerrur dhe pa epsh

që mjaullin me trok yjesh pa dritë.  
Është harem qorrash që s'kanë kurrëfarë kuptimi  
dhe s'të udhëheqin asgjëkundi!  
Varrezë politikanësh të mbytur në krenari idiote,  
kënetë e degjeneruar karakteresh dhe WC-sh,  
bordellosh dhe "najtclub-esh",  
flutur e lodhur së gënjyeri  
në hane pa porta.

Është më mirë të vdesësh  
kur idhujt bëjnë luftë në sofrën tënde  
për një shans më shumë!!!

1 Korrik 1999



\*\*\*

I udhëheq vargjet në arrati mike.  
largësinë  
Mbys  
në honet e trurit  
që akordon kitarat e qetësisë!  
Jam rritur  
ti mbaj kujtimet  
si trofe luftrash  
a ndoshta dua ti jap vargut  
fytyrën e së nesërmes.

Të kisha harruar,  
fshehur diku në moskokçarjen time  
më masturbon etniken  
me leksikologjinë egoiste.  
Le të më mbysin kujtimet këte çast.  
Kam mbetur tek kthesa e fëmijërisë  
dhe kërkoj të zgjoj djallëzirat  
tani që largësia më sërëvir gota të shterrura kotësie.  
Nuk më lë kurrë vetëm psherëtima!  
Të pyes,  
por ti fle në fakte që s'fajësojnë  
dhe kërkon ti japësh intrigës tënde  
një flatër engjëlli më shumë!  
Ky triniteti yt i shenjtërt,  
ma gozhdon mbrëmjen e veshur  
me guxim të kaltër poeti,  
në arratisje eunukësh dhe llafazanësh pa patetikë.  
Sikur ti ndryj pikëtakimet në shmangie.  
Arkivol miqësie armike  
toleranca dhe anashkalimi le të flenë  
me pushkë nën jastëk.

Lermë vetëm.  
Braktisi ujrat e mia  
dhe kridhu në narcizmin tënd nihilist.  
I përkas të nesërmes dhe kështu,  
i veshur me ikonën e zhvirgjëruar dhunshëm  
të llafologjisë tënde homofobe  
ndihem krejt shenjt edhe pse darka gëlon nga orgji  
dhe dhunë.

1 Korrik 1999

\*\*\*

Të pjekura  
Vdekja dhe jeta  
si dy caqe të një aventure  
harlisen në rrënjë të dala instikti.

Të shtrydhësh...  
edhe mbijetesën...  
dhe të hukasësh pastaj  
trofetë e luftës pa shkak  
në lodrimet pa fre të shtunave  
kur qëllimi shtrihet dhe vdes ne fillime analoge.

Mos ti shpjegosh kotësitë e gjykimit  
në çaste kur cicërijnë mëngjeset,  
as kur gjysmëhënat rriten në filma pornografikë  
si oaze në instiktin e etur të zbardhjes.  
Ulërimat, ofshamat  
lëshoji tërbuar në eksitimin e budallëkut.  
Kuptimi, turbullira dhe trazira  
lindin mospërputhjen me shpirtin,  
guackën e tradhtuar nga jehja!  
Alkoli,  
elektroliti barazpeshë i fajit  
dhe rrënimi  
ose çfarëdo  
strehohen në kocka shtëpish  
dhe marramëndjesh.

Të dielave,  
kryesisht të dielave  
ia vlen të jepësh.

11 Korrik 1999

\*\*\*

Orgazma të shtrydhura  
Ditë- netët,  
dhe kuvendet,  
dhe konstatimet e kulluara kronologjike.

Dua art, art  
ta mjekoj guximin!

Mbetur  
si një relike  
brenda meje  
I keqi është i mirë  
dhe i miri prishet në vete.

Notoj në poezi të ndenjura,  
moçal shprese,  
gjaku mi njeh të gjitha shtysat,  
dhe kurvërimet pa cak të fjalës.

Arti, arti  
më dhëmb së fundi!

11 Korrik 1999

\*\*\*

Në emisione ku bëhem hero  
zgjidh enigma  
ku përfundimi hedh poshtë kohën.  
Ti shpjegoj hobet e mia  
duke të treguar banjot kolektive të onanizmit.  
Thyeji të gjitha mundësitë  
të nxjerrin përballë meje.  
Nuk jam i vetmi  
që s'mund ti ul yjet nga qielli  
dhe të ti këndoj këngët e Witmanit.  
Çernobili i prostates,  
më shpie çdo fundjave në bordello.  
Testet urinare  
qarkullojnë në internet  
duke mbledhur opinione të atypëratyshme.

Pushoje femijën që qan nën sqetull!!!

Dy herë zura mat veten  
dhe 16 robërit e kthyer në mikse llogjikash  
ma tjerrin edhe më celulitin e eterit.

S'ma shpëton asgjë poetin!!!

22 Korrik 1999

\*\*\*

Fryn  
rrugicave të Athinës!

Nuk është ora të vdesësh!  
As ti zhvarrosësh  
mbeturinat e së djeshmes.

Është ora të kridhesh në vete  
si një statuje e heshtur  
dhe dëshmime tu plotësosh ngurtësimin e nderlikuar të shekujve.  
Këmbënguljen ta emërosh,  
ti zgjidhesh magjitetë e heshtjes,  
rrjedhën e fjalëve,  
korin e lodhur të cicërimave,  
edhe vargjet, mbeturinat,  
ta pish natën në gotën e vetmisë  
e të mos ndihesh vetëm.

Është ora të çlirohesh,  
dhe deliret ti mjekosh  
ndoshta ngaqë  
Athina ka mbetur vetëm  
edhe nga shiu!

12 Korrik 1999

\*\*\*

Fjalëkryqi i zorit,  
Nerudë i tredhur.  
Kulturë impotente me themel  
në bisht të arushës së vogël.  
Shikim i ngulur në cepe pallatesh.

Në mesnatë fillon dita ime.

Ma mëkon ikjen  
uji i ndenjtur i vetgënjimit  
Rrebele i kam ëndrrat  
dhe kur urinoj.  
Krenari sakate,  
cigare në djegie,  
sekuenca erotike të stinëve  
me eklipse të kota të arsyes.

Këndoj psalme të zhveshura nga morali!

Mesdita mbetet në guxim e velur.  
Në ç'ekuinox  
lindja do braktisë vdekjen???  
Dritëfikur 40 ditët e përshpirtjes  
se ringjallin të vdekurin.  
As ritmi i lodhjes, përpjekjes.

Ia lë tendencat peng,  
një përpjekjeje tjetër.  
Në brekët e mia  
këmbanat  
pijnë testikuj klishe të mashkullsisë së zhveshur.  
Persiatje të aromatizuara  
si një besim i braktisur nga nderi,  
kulti i njeriut fle  
në postulatin e brejtur të narçizmit!

Dritë,  
trup,  
ajër  
të ndihem

\*\*\*

Parafinë e shkrirë  
mirëkuptimi mes nesh.  
Zog i lodhur shtegtimesh,  
shpresa dhe paqja ngrohen në një krevat të lagur  
me benzinë.  
Të ikur prej vetes,  
betohemi për ndershmëri,  
Nuk kam armë!  
Mos fol.  
Heq shpirt shpirti i paqes!

Mbyllur ne kornizë  
ndërgjegja dhe arsyeja  
s'mund të lindin kurrë  
Migjen dhe Sokrat.  
Të flasësh,  
edhe pse më përdhunon mirësjellja jote!

Tani varros pengje.  
Jam i uritur  
ti dëgjoj agimet, shpirt,  
a më dëgjon,  
je pjesë imja  
edhe pse s'ngutem të vdes.

Oh, si s' mund ti hap dyert e shpirtit.

Parafinë e shkrirë darka!  
Parafine e pashije e nesërmja,  
deri në fyt me mut e shurrë.  
Mi fal fjalët,  
s' meriton shenjti plagë!  
E papërmbajtshme ulërima,  
kur plaga e vjetër ka vend për një plagë tjetër!

Kaosi, kaosi  
më mbush!!!

15 Korrik 1999

\*\*\*

Rrëmuje poetike,  
në sirtaret e mia  
pulson arti!

Barazpeshohen lavditë  
dhe idhujt pijnë kafe  
në sofrën boheme të romantikes!

Arti  
I pambarim edhe kur dhemb!!!

17 Korrik 1999



\*\*\*

Përse hesht???

Mi djeg largësia fjalët!  
Krijoj engjëjt  
të mi kthejnë  
shëtitorët e psherëtimës  
në shira pranveror.

Përse hesht a s'më thua?  
Muzika e mesnatës,  
notat e një mëngjesi në ardhje,  
ti më mungon

Ti më mungon!!!

2 Korrik 1999

\*\*\*

Mi bren kockat padurimi.  
Shtrirë përgjatë squlljes së pagjumësisë  
të nesërmet e mia  
cithen si qen të tredhur  
në fundjava të lëshuara me qira  
si krevate vejushash!  
I ngatërruar kodi i guximit,  
si pavendosmëri fatalisti  
tik-taku i saj  
bren edhe fjalën më të rëndomtë.  
Jepem i tëri  
dobësisë dhe pasigurisë së djallëzuar.  
Në krevatin dhe kraharorin e përbuzur të vetes  
mbështjellë me fasho minjsh dhe acide djegëse  
libidoja ime kridhet në fllade perverse,  
i dehur në ekstazën e venitur  
të çmendurisë.

6 Gusht 1999